



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

---

**AD/GJTHPR/28/24**

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. N.S ndaj gjyqtarit J.M, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë: 19.12.2024 nxjerr këtë:

### **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. N.S të paraqitur ndaj gjyqtarit J.M, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

### **A r s y e t i m**

Me datë 20.11.2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke vepruar konform nenit 9 paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë te autoritetit kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga av. N.S ndaj gjyqtarit J.M.

Me datë 25.11.2024, Kryetarja e Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 paragrafi 5 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga av. N.S ndaj J.M.

Parashtruesi i ankesës në ankesën e tij ka deklaruar se gjyqtari J.M, ka kryer shkelje disiplinore gjatë trajtimit të lëndës R.nr.40/23 ku caktoi një përfaqësues të përkohshëm e më pas të njëjtën e shkarkoi gjatë seancës, dhe më pas caktoi një avokat tjetër, pa ndjekur procedurën e përfaqësuesit të përkohshëm duke kontaktuar Odën e Avokatëve të Kosovës për të deleguar një përfaqësues të përkohshëm, por avokatin e ka caktuar drejtpërdrejtë, sipas zgjedhjes së tij, gjë që ka ngritur dyshime për arsyet e angazhimit të përfaqësuesit të përkohshëm. Po ashtu, sipas tij vendimet për caktimin e përfaqësuesve të përkohshëm nuk janë në përputhje me pikën III të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e as nuk ishin të afishuara në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Tutje parashtruesi i ankesës ka deklaruar se në çështjen përmbarimore PPP.nr.08/24 përkundër urgjencave të dërguara nuk caktoi seancën në këtë lëndë përmbarimore me qëllim të zgjidhjes përfundimtare duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në rritjen e panevojshme të shumës së kërkuar nga përmbaruesi privat, që nënkupton të kamatës mbi borxhin kryesor të debitorit përmbarimor dhe garantuesit.

Tutje avokati në cilësinë e parashtruesit të ankesës ka deklaruar se gjyqtari J.M ka shkelur ligjin edhe në çështjen përmbartimore PPP.nr.24/08 pasi që nuk ka respektuar nenin 199 të Ligjit nr. 03/L-006 për procedurën kontestimore, i cili përcakton se gjykatat pas pranimit të vendimit të gjykatës së shkallës së dytë, është e obliguar të mbajë seancë jo më vonë se 30 ditë pas pranimit të vendimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Në lëndën P.nr.60/24, sipas parashtruesit të ankesës gjyqtari nuk ka respektuar rendin e paraqitjes së padive ku objekt i kësaj lëndë është vërtetimi i të drejtave pronësore në bazë të mbajtjes, ku sipas tij kjo padi është dorëzuar në Degën e Gjykatës në Graçanicë me datë 08.04.2024, ndërsa pa i lënë fare afat të paditurit që të parashtroj përgjigje në padi për pretendimet e ngritura në padi, në mënyrë të kundërligjshme dhe pa radhë ka caktuar seancën përgatitore për shqyrtim kryesor me datë 18 Tetor 2024, ku praktikë e gjykatës në këto raste është që shkojnë deri në 2, 3 a po 4 vite për të caktuar seancën. Sipas tij ky veprim i gjyqtarit krijon dyshime për arsyet se përse ai nuk e ka respektuar rendin në të cilin kanë ardhur paditë por ka vepruar në mënyrë diskriminuese.

Sipas parashtruesit të ankesës, me këto veprime gjyqtari J.M ka dhënë shembull negativ në opinion dhe ka dëmtuar reputacionin e institucioneve gjyqësore të Republikës së Kosovës, përfaqësues i të cilave si gjyqtar individual është i detyruar ti mbrojë.

Në fund ka deklaruar se kjo ankesë dhe provat e bashkangjitura do të vërtetojnë qartë se veprimet e gjyqtarit J.M kanë elemente të përgjegjësisë disiplinore të parapara me nenin 5 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.3 si dhe elementet e shkeljes së detyrës së gjyqtarit nga neni 2 pika 2.7 e Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe shkelje të nenit 3, pika 3.1, 3.2 dhe neni 5 t; Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Në lidhje me ankesën e parashtruar, gjyqtari i çështjes përmes emailit të datës: 03.12.2024, adresuar Kryetares së Gjykatës, ka deklaruar se në lëndën me numër R.40/23, përfaqësuesi i propozuesit N.J avokati N.N, kishte propozuar, ndarjen fizike të regjistrit kadastral parcelat P-00201-0, P-00209-0, P-00211-0, P-00217-0, P-00218-0 dhe P-01678-0, me kundërshtarë të propozuesit I.M dhe I.M. Sipas tij, dispozitat e nenit 198 të Ligjit për procedurën jashtë kontestimore, procedurën për pjesëtimin e sendeve dhe të paluajtshmerive në bashkëpronësi mund ta fillojë secili nga bashkëpronarët. “Çështja e paraqitur në gjykatë duhet të përfshijë të gjithë bashkëpronarët” – sipas dispozitës ligjore të cituar, pasuria e paluajtshme mund të ndahet fizikisht ndërmjet bashkëpronarëve. Tutje ka deklaruar se në seancën e kaluar, gjykata kishte kërkuar dëshmi nga Shërbimi i Kadastrës së Patundshmërive në Graçanicë se kush janë bashkëpronarët e parcelave të sipërpërmendura dhe me datë 22.11.2024, gjykata kishte pranuar raport dhe fletat poseduese për të gjitha ngastrat kadastrale të lartpërmendura, nga të cilat është konstatuar se bashkëpronarë të parcelave kadastrale të lartpërmendura janë N.S në ½ dhe V.L në 1/2.

Sipas tij, kundërshtarët e propozimit, I dhe I . N, nuk janë bashkëpronarë të ¼ e ngastrave kadastrale të përshkruara, kështu që ndarja fizike ndërmjet propozuesit dhe kundërshtarit të propozuesit nuk lejohet, pasi propozuesi dhe kundërshtari i propozuesit me këtë do ta ndanin fizikisht ngastrën kadastrale të huaj dhe do te regjistronin të drejtat e pronësisë mbi të.

Gjyqtari J.M tutje ka deklaruar se përfaqësuesi i propozuesit avokati N.S, i referohet aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë - dega në Graçanicë, C.nr.

203/22, të datës 29.12.2022, ku sipas tij ky aktgjykim nuk mund të prodhojë efekt juridik dhe për këtë arsye kundërshtarët e propozuesit nuk mund të regjistroheshin në bazë të saj si bashkëpronarë të ¼ e ngastrave kadastrale të mësipërme. Këtë aktgjykim gjyqtarja e çështjes M.D e ka sjelle në atë mënyrë që i ka lejuar palët ndërgjyqëse që të njohin reciprokisht të drejtën e pronësisë në tokën e huaj të ½ e ngastrave kadastrale të përshkruara më sipër në pronësi të L.V. Tutje ka deklaruar se në këtë lende, për shkak të adresave të panjohura të kundërshtarëve të propozuesit, gjykata ka caktuar një përfaqësues të përkohshëm për kundërshtarët e propozuesit, L.T. Megjithatë, në njërin nga seancat, përfaqësuesi i përkohshëm, edhe pse nuk ka autorizim ligjor për ta bërë këtë, ndërmori veprime në kundërshtim me dispozitat kontestimore - pranoi propozimin e propozuesit dhe hoqi dorë nga e drejta e ankimit. I njëjti tutje ka deklaruar se duke qenë se përfaqësuesi i përkohshëm nuk ka kompetencë të heqë dorë nga e drejta e ankimit, të pranojë kërkesëpadinë, të heqë dorë nga padia ose të pranojë propozimin, këto veprime kontestimore nuk prodhojnë efekt kontestimore, prandaj gjykata i shpalli të pavlefshme dhe e anuloi vendimin për caktimin e L.T si përfaqësues të përkohshëm për faktin se në këtë rast ai nuk ka mbrojtur interesat e kundërshtarëve të propozuesit dhe se është dashur të dijë se ½ nga parcelat e kontestuarra janë pronë e huaj, ndarja fizike e së cilës është e paligjshme.

Gjyqtari në deklarin e tij ka theksuar se, pas kësaj gjykata caktoi një përfaqësues tjetër të përkohshëm. Në seancën e kaluar ka kërkuar raporte se cilët janë bashkëpronarët e parcelave kontestuese dhe pasi që me dt. 22.11.2024. ka pranuar raportet - do të marrë vendim për këtë rast sa më shpejt që të jetë e mundur.

Lidhur me pretendimet e ankuesit në çështjen përmbartimore PPP.br.08/24, gjyqtari ka deklaruar se një nga provat e rëndësishme për vërtetimin e fakteve relevante është Kontrata mbi Hipotekën, e cila është dorëzuar për përkthim dhe për shkak të mbingarkesës së përkthyesit kontrata akoma nuk është përkthyer, kur do që të përkthehet, gjykata pa caktim të seancës do të vendosë sipas kundërshtimit të debitorit përmbartimor me urdhër të përmbartuesit privat. Sipas tij, duke qenë se bëhet fjalë për një mosmarrëveshje me vlerë të madhe rreth 500.000,euro, gjykata është e obliguar të shqyrtojë të gjitha faktet, veçanërisht nga kontrata që është dhënë për përkthim dhe më pas të vendosë për kundërshtimin.

Gjyqtari i çështjes në deklarin e tij përmes email-it adresuar Kryetares së Gjykatës, ka dhënë përgjigje edhe lidhur me pretendimet e ankuesit për lëndën C.nr. 114/24. I njëjti ka deklaruar se lënda është e vitit 2015 dhe është kthyer me ankesë, gjykata ka caktuar seancën për në fund të janarit 2025. Për shkak të numrit të madh të lëndëve, gjykata nuk ka mundur ta caktojë atë më herët.

Ndërsa lidhur me rastin C.nr.60/24, për të cilën çështje ankuesi kishte dhënë pretendimet e lartë cekura, gjyqtari J.M ka deklaruar se përfaqësuesi i të paditurit ka pranuar padinë (gjykata ka lëshuar vendim me padi që ta udhëzojë që në afat prej 15 ditësh të përgjigjet në padi dhe të tregojë se në çfarë kuptimi duhet të jep përgjigje në padi). Mirëpo, përfaqësuesi i të paditurit i është përgjigjur padisë me deklaratë me shkrim, në seancën e parë dhe ka kërkuar që përfaqësuesi i paditësve të pranojë deklaratën me shkrim si përgjigje ndaj padisë, të cilën përfaqësuesi i paditësit e ka pranuar. Kurse, përfaqësuesit të të paditurit nuk i është mohuar e

drejta për t'u mbrojtur sepse atij i është dorëzuar një padi, së cilës i është përgjigjur dhe është pajtuar me palën kundërshtare që deklarata e tij me shkrim në padi të jetë realisht përgjigje. Më tej, në lidhje me pretendimin se seanca e datës 18.10.2024 është caktuar në mënyrë të paligjshme duke mos e respektuar radhën, gjyqtari ka deklaruar se sipas Ligjit të Procedurës Civile, gjykata është e autorizuar të vendosë se cilat veprime do t'i ndërmarrë në një rast konkret, me fjalë të tjera, cilat fakte do t'i vërtetojë, cilat prova do t'i administrojë, cilat mjete provuese do t'i përdorë, në çfarë mënyre do të administrojë prova, a do të caktojë përfaqësues të përkohshëm, kur do të revokojë vendimin për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm dhe veprimet e tjera kontestimore, si dhe të caktoj seancat gjyqësore sipas ligjit dhe të caktoj kohën e seancës, pasi që kjo nuk është në domenin e avokatit, por të gjykatës.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, Autoritetin Kompetent gjeti se:

***- ankesa disiplinore është e pabazuar.***

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë vlerëson se në rastin konkret pas shqyrtimit të ankesës nuk ka arritur të provojë pretendimet e palës ankuese në lidhje me shkelje të ligjit a po për shkelje të detyrave të tij zyrtare si gjyqtar, pasi që në këtë drejtim parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar prova për të argumentuar se si rezultat i cilave fakte ka arritur të konstatojë se gjyqtari ka shkelur pavarësinë e tij, a po është treguar i njëanshëm, a po çfarë sjellje është manifestuar nga gjyqtari i rastit e cila bie ndesh me Kodin e Etikës për gjyqtarë apo veprime të cilat hyjnë në domenin disiplinor, sipas Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Pretendimet se gjyqtari i çështjes në çështjen kontestimore R.nr.40/23 nuk ka respektuar ligjin dhe ka caktuar përfaqësues të përkohshëm në kundërshtim me procedurën e paraparë ligjore, Autoriteti Kompetent konsideron se një fakt i tillë mund të goditet me ankesë ndaj aktgjykimit si pretendim për shkelje të dispozitave procedurale, por assesi nuk mund të konsiderohet pretendim për shkelje disiplinore të gjyqtarit, sepse shkeljet disiplinore janë të përcaktuara në mënyrë decitive në nenin 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në bazë të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, cilat fakte do t'i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit.

Në lidhje me pretendimin tjetër se gjyqtari me qëllime të caktuara nuk ka ndërmarrë veprime në trajtim të lëndën PPP.nr.08/24, në bazë të deklaratës së gjyqtarit por edhe konstatimeve nga zyra e përkthimeve pranë Degës së Gjykatës në Graçanicë, është vërtetuar se gjyqtari i çështjes me datë 28.10.2024 ka dorëzuar pranë zyrës për përkthim kontratën mbi hipotekën, me qëllim të shqyrtimit të të njëjtës në gjuhën që i njëjti e kupton. Andaj, si rezultat i kësaj nuk mund të vërtetohet fakti se gjyqtari me qëllim të shkaktimit të dëmeve të ndonjëres palë nuk ka vendosur në lidhje me kundërshtimin e debitorit. Vlen të theksohet se gjyqtari i çështjes ka kompetencë ekskluzive në ndërmarrjen e të gjitha veprimeve procedurale me qëllim të trajtimit të lëndës dhe vërtetimit të fakteve kontestuese, andaj një pretendim i tillë nuk mund të konsiderohet si shkelje disiplinore e gjyqtarit.

Ndërsa lidhur me pretendimet se gjyqtari i çështjes, nuk po cakton seancat në afate ligjore në rastet e kthimit të lëndëve në rigjykim, këto pretendime nuk janë bazë për shkelje disiplinore të gjyqtarit pasi që është fakt notor se për shkak të numrit të madh të lëndëve të pranuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë duke e përfshirë këtu edhe Degën në Graçanicë, gjyqtarët nuk mund të caktojnë seanca në respektim të afateve ligjore, andaj mos caktimi i seancës gjyqësore për trajtim dhe vendosje të lëndës PPP.nr. 24/08 lënde ka ndodhur për shkak të faktorit objektiv e jo për shkak se gjyqtari me veprimet apo mosveprimet e tij po ndikon qëllimshëm në zvarritje a po mos trajtim të lëndës.

Ndërsa, pretendimi për caktim të seancës në lëndën P.nr.60/24 brenda një afati kohor prej 6 muaj nga paraqitja e padisë, duke pas parasysh natyrën e kontestit që është vërtetim pronësie e që për nga praktika seancat për shqyrtimin e këtyre lëndëve marrin disa vite për trajtim, Kryetarja e Gjykatës ka kërkuar informata nga gjyqtari në fjalë në lidhje me lëndët me të cilat i njëjti është i ngarkuar e që i takojnë këtij kontesti, me ç rast nga deklarata e të njëjtit dhe nga sistemi SMIL është vërtetuar se të gjitha lëndët e viteve më të hershme se viti 2024 e që i takojnë kësaj natyre e të cilat gjyqtari J.M i ka trashëguar janë në punë, me veprime a po të përfunduara.

Andaj, si rezultat i kësaj, gjyqtari i çështjes në bazë të organizimit dhe planit të tij të punës, ka vlerësuar se në lëndën në fjalë mund të ndërmerret veprime në drejtim të trajtimit dhe vendimmarrjes.

Kryetarja e Gjykatës nuk ka kompetencë të vlerësoj vendimmarrjen e gjyqtarit a po mënyrën se si gjyqtari trajton lëndën deri në vendimmarrje, pasi që rregullat e trajtimit të një çështje të caktuar në procedurë civile janë të caktuara me ligjin në fuqi, andaj nëse palët pretendojnë se vendimi i gjyqtarit është i përfshirë në shkelje të dispozitave ligjore apo procedurale, legjislacioni në fuqi ka paraparë mekanizmat ligjor të goditjes së vendimeve me mjete të rregullta a po të jashtëzakonshme në instanca më të larta.

Në këtë drejtim, me nenin 107 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës parashihet: “Gjyqtarët, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtarë”, e po ashtu parimi i njëjtë mbrohet edhe nga instrumentet ndërkombëtare ku në Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjyqtareve, ku parashihet: "Gjykatësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre duhet të jenë të lirë për të vendosur mbi çështjet në mënyrë të paanshme, në përputhje me vlerësimin e tyre të lirë të fakteve dhe të kuptuarit e tyre të ligjit”.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/28/24, me datë: 19.12.2024

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë